



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 55

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
ROSKOVEC, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Bashkia Roskovec

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Roskovec për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Bashkia Roskovec ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 10.00, me tematikë “Informim/ndërgjegjësim”, “Çështje sociale”, “Ftesë për zhvillimin e një trajnimi me teme “Trajnim për një jetë të shëndetshme” e zhvilluar nga ACA – Albania

Data: 31.1.2025 Nr: 55
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Roskovec për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

Community Assist. Save the Children po zbaton Projektin e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC): “Shkollat për Shëndetin”.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Roskovec një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t’i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Roskovec ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Bashkia Roskovec ka pasur një ftesë për zhvillimin e aktivitetit dhe nuk ka qenë organizatori i këtij trajnimi. Ftesa ka ardhur me email dhe pavarësisht se ishim të ftuar, kemi bërë raportimin në sistem”.*

Pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, konstatova se Bashkia Roskovec nuk ka patur mundësi të raportojë në kohë për këto aktivitete për shkak se ka qenë në cilësinë e të ftuarit.

Për sa më sipër, referuar pikës 3, të nenit 5, të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, veprimtaritë ku institucioni publik apo përfaqësues të tij janë ftuar për të marrë pjesë, nuk mbartin detyrimin për t’u raportuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Roskovec.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI